

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 8027/1 prot.
Datë 07.12.2021

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 22/48/1 prot.
Datë 16.12.2021

UDHËZIM

Nr. 23, datë 07.12.2021

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 26.2.2021 "PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6, të Ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të Ligjit nr. 137/2021, "Për buxhetin e vitit 2021", të pikës 4, të VKM-së nr. 1102, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2021",

UDHËZOJMË:

Në Udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2021 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në Kreun V, pas paragrafit "Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit është 15 ditë kalendarike pas publikimit të listës së aplikantëve të kualifikuar, në faqen zyrtare www.azhbr.gov.al", shtohet paragrafi me formulimin: "Për fondet shtesë të akorduara sipas Aktit Normativ nr. 34, datë 3.12.2021, afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit është 5 ditë kalendarike pas publikimit të vijës së financimit, të përditësuar sipas listës së aplikantëve të kualifikuar, në faqen zyrtare www.azhbr.gov.al".
2. Në Kreun VI, Masa 5, nëndarja "iii", shkronja "a", zëvendësohet me formulimin: "Dokumentet e certifikimit (certifikatë për statusin e certifikimit dhe anekset e certifikatës ku tregohet kultura e certifikuar) lëshuar nga një trupë kontrolli e miratuar nga MBZHR". Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, mund t'i dorëzojë pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem.



3. Në Kreun VI, Masa 6, nëndarja "iii", shkronjat "c" dhe "e", zëvendësohen përkatësisht me formulimet: "c. Faturë tatimore për koston e procesit të implementimit/ose konfirmimin e pagesës së kryer nga aplikanti kur shërbimi i certifikimit është kryer online"; "e. Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit".


Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, mund t'i dorëzojë pranë agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem.

4. Në Kreun VII, pas pikës 4, shtohen pika 4.1 dhe 4.2, me formulimet si vijon: "4.1 Të gjithë aplikantët mbi vijën e financimit, sipas evidentimeve në listën e shpallur në dhjetor 2021, kanë afat deri në 5 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve, të dorëzojnë dokumentet e kërkuar në agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose me postë në zyrat qendrore të AZHBR-së". "4.2 Përgjashtëmësisht për Masën 1, AZHBR mund të bëjë verifikime në terren për aplikimet, të cilat kanë plotësuar kriteret e përfitueshmërisë por ndodhen jashtë vijës së financimit dhe që për shkak të lëvizjes së vijës së financimit mund të shpallen fitues pas datës së verifikimit".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHYLLIMIT RURAL**

FRIDA KRIFÇA



**MINISTËR I FINANCËVE
DHE EKONOMISË**

DEJZINA ABRAHIMAJ

